



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

Seanca Plenare  
Seanca nr.2003/16  
Prishtinë,më 22 maj 2003,në orën 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit,salla plenare.

**PROCESVERBAL**

Seancën e kryesoi Nexhat **DACI**, kryetar i Kuvendit, kurse bashkëkryesues ishte Oliver Ivanoviq,anëtar i Kryesisë.  
Kryesusi konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 85 deputetë dhe shpalli të hapur punën e saj.

Në seancën e mëparshme ishte miratuar rendi i punës i kësaj seance,si vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme.
2. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për plehrat-2003/8.
3. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për qasje në dokumente zyrtare-2003/11.
4. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për regjistrimin e popullsisë,ekonomive familjare dhe të banesave.
5. Shqyrtimi i propozimit të grupit parlamentar "Kthimi"për emrimin e disa anëtarve në komisionet e Kuvendit
6. Shqyrtimi i rekomandimit të Këshillit Gjyqësor dhe Prokurial të Kosovës për emrimin e gjyqtarëve.
7. Parashtrimi i pyetjeve dhe
8. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare që duhet të mbahet më 29 maj 2003.

Kryesuesi kërkoi nga deputetët e Kuvendit që të procedohet sipas rendit të ditës të miratuar në seancën e mëparshme.

### 1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme.

Nuk pati vërejtje lidhur me procesverbalin e seancës së mëparshme dhe ai u miratua.

### 2. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për plehrat -2003/11.

Kryesuesi i vuri në votim amendamentet e Komisionit për Buqësi,Pylltari dhe Zhvillim Rural,të përkrahur nga Komisioni për Buxhet,nga Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe nga Komisioni për Çështje Gjyqësore,Legjislacion dhe Komizë Kushtetuese,një nga një në këtë P/ligj.

Kuvendi i miratoi amendamentet:1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12,13,14,15,16,17 dhe 18.

Kryesuesi e vuri në votim P/ligjin në tërsi dhe rezultati ishte si vijon;

Për----- 85,

Kundër----0,

Abstenime-0.

**Kryesuesi konstatoj:Kuvendi i Kosovës e miratoi Ligjin për plehrat.**

### 3. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për qasje në dokumente zyrtare-2003/11.

**Kryesuesi** e ftoi ministrin e Shërbimeve Publike që ta arsyetonte P/ligjin para deputetëve të Kuvendit.

**Ministri Jakup Krasniqi** tha se P/ligji për qasje në dokumente zyrtare ka për qëllim ngritjen e nivelit të qeverisjes së mirë,të transparencës dhe të përgjegjësisë së organeve publike para qytetarëve të Kosovës për të siguruar qasje të lirë në dokumente zyrtare.Kjo politikë e “derës së hapur”,shtoi ministri Krasniqi,duhet të rezultojë në ngritjen e ndjenjës së përgjegjësisë brenda organeve publike dhe do të jetë si mjet i rëndësishëm për luftimin dhe zhdukjen e dukurive negative të shoqërisë e në radhë të parë të korrupsionit.

Në këtë P/ligj janë përfshirë normat dhe standardet më të avansuara të kësaj fushe të Unionit Evropian me qëllim të ngritjes së një administrate moderne,transparente dhe të përgjegjshme para qytetarëve të Kosovës.

Në aspektin juridik,P/ligji përmban përkufizime të qarta në definimin e termit “dokumente zyrtare” dhe cili është fushëveprimi i këtij ligji.Ai rregullon të drejtat e qytetarëve në përdorimin e dokumenteve zyrtare.

Ky P/ligj,në të njejtën kohë mbron edhe interesat e institucioneve publike të Kosovës që e kufizojnë të drejtat e qytetarëve për qasje në dokumente zyrtare që kanë të bëjnë me çështje të sigurisë publike,çështjeve të mbrojtjes dhe atyre ushtarake,marrënieve

ndërkombëtare si dhe të politikave fiskale dhe monetare që rregullohet me norma të veçanta.

Në fund, ministri Krasniqi i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratonin këtë P/ligj.

**Opinionet, vërejtjet dhe sugjerimet e veta në këtë P/ligj i dhanë edhe deputetët: Lirak Çelaj, Blerim Baruti, Lilana Keniq, Zylfije Hundozi, Muhamed Kelmendi dhe Sabri Hamiti që i janë bashkangjtur transkriptit.**

Kryesuesi e vuri në votim këtë P/ligj dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----shumica,  
Kundër-----9,  
Abstenime-----3.

**Kryesuesi** konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim P/ligjin për qasje në dokumente zyrtare dhe ngarkoi Komisionin për Shërbime Publike, si komision funksional dhe raportues si dhe Komisionin për Çështje Gjyqësore dhe Komizë Kushtetuese, Komisionin për Buxhet dhe Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komunitetve që ta shqyrtojnë këtë P/ligj në afatin kohor për tre javësh dhe t'i paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime lidhur me këtë P/ligj.

#### **4. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe të banesave.**

**Kryesuesi** e ftoi ministrin e Shërbimeve Publike që ta arsyetonte P/ligjin para deputetëve të Kuvendit.

**Ministri Jakup Krasniqi** tha se ky P/ligj ofron zgjidhje ligjore-sistimore për zbatimin e regjistrimit të popullsisë dhe duhet të autorizohet Enti Statistikor i Kosovës që të organizojë regjistrimin më 1 prill 2004, me të cilin sigurohen të dhënat për: strukturën demografike dhe karakteristikat kryesore socio-ekonomike të popullsisë; numrin e përgjithshëm dhe shpërndarjen e territoriale të popullsisë së Kosovës; numrin, shpërndarjen hapsinore dhe strukturën e vendbanimeve dhe të ndërtesave të shfrytëzuara me qëllim banimi dhe destinime tjera; kushtet e banimit dhe standardet jetësore të popullsisë.

Qëllimi i regjistrimit të popullsisë dhe të ekonomive familjare në Kosovë, shtoi ministri Krasniqi është që të sigurohen të dhëna të plota për karakteristikat socio-ekonomike dhe demografike të popullsisë, të banesave si dhe analizimin dhe shpërndarjen e të dhënave për shfytësuesit e interesuar të institucioneve shtetërore-publike dhe të atyre private.

Ministri Krasniqi e paraqiti strukturën e këtij P/ligji të radhatur në katër kapituj, që normohet materia e cekur më lartë.

Në kapitullin parë, përfshihet qëllimi i regjistrimit, objekti ligjor, autoriteti i regjistrimit, data dhe perioda e evidentimit, subjekti dhe rezultatet e regjistrimit me regjistra statistikor.

Në kapitullin e dytë,përfshihen kompetencat dhe raportet e organeve përgjegjëse për regjistrim,përkatësisht Komisioni qendror i regjistrimit dhe të organeve të tjera qendrore dhe të atyre komunale.

Në kapitullin e tretë,përcaktohet obligimi i Qeverisë,i ministrisë së Shërbimeve Publike,i ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave,i Entit Statistikot të Kosovës që të bëjnë përgatitjet për regjistrim dhe t'ia dërgojnë Kuvendit të Kosovës për miratim.

Në kapitullin e katërt,përfshihen procedurat e regjistrimit,publiciteti i mediave gjatë fushatës së regjistrimit dhe obligimet e të gjitha institucioneve që janë përgjegjëse për realizimin e regjistrimit.

Në fund,ministri Krasniqi i ftoi deputët e Kuvendit që ta miratonin këtë P/ligj.

**Opinionet,vërejtjet dhe sugjerimet e veta në këtë P/ligj i dhanë edhe deputët:Sabri Hamiti,Ismajl Kurteshi,Dragisha Krstoviq,Fetije Këpuska,Naim Maloku,Ramadan Kelmendi,Rrustem Ibishi,Mahyr Jakxhillar dhe Tomë Hajdaraj,që i janë bashkangjitur transkriptit.**

Kryesuesi e vuri në votim këtë P/ligj dhe rezultati ikshte si vijon:

Për-----shumica,

Kundër-----11,

Abstenime-----0.

**Kryesuesi** konstatoi:Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim P/ligjin për regjistrimin e popullsisë,ekonomive familjare dhe të banesave,si dhe ngarkoi Komisionin për Shërbime Publike si komision funksional dhe raporues,Komisionin për Çështe Gjyqësore ,Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese,Komisionin për Buxhet dhe Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve që ta shqyrtojnë këtë P/ligj në afatin kohor për tre javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet dhe rekomandimet lidhur me këtë P/ligj

#### **5. Shqyrtimi i propozimit të grupit parlamentar “Kthimi”për emrimin e disa anëtarve në komisionet e Kuvendit.**

Grupi parlamentar “Kthimi” kishte propozuar që deputeti Aleksandar Nojkiq të jetë zëvendëskryesues i dytë në Komisionin për Shërbime Publike,Rangjel Nojkiq të jetë zëvendëskryesues i dytë në Komisionin për Persona të Zhdukur,Petar Radosavljeviq të jetë anëtar i Komisionit për Gatishmëri dhe Emergjencë.

Kryesuesi e vuri në votim propozimin e këtij grupi dhe rezultati ishte si vijon:

Për----- shumica,

Kundër-----0,

Abstenimë-----3.

Kryesuesi konstatoi:Kuvendi i Kosovës e miratoi propozimin e grupit parlamentar "Kthimi" për emrimin e anëtarëve të cekur më lartë,në komisionet e Kuvendit.

#### **6.Shqyrtimi i rekomandimit të Këshillit Gjyqësor dhe Prokurial të Kosovës për emrimin e gjykatësve dhe të prokurorëve.**

**Kryesuesi** e ftoi kryetarin e Komisionit për Çështje gjyqësore,Legjislative dhe Kornizë Kushtetuese që të paraqesë rekomandimin e komisionit lidhur me këtë çështje.

**Arsim Bajrami** tha se në seancën e mëparshme është vendosur që të kërkohet informata shtesë për z.Feti Tunuzliu,që ishte rekomanduar nga Këshilli Prokurial dhe Gjyqësor për zëvendës të prokurorit publik në Mitrovicë.Komisioni i ka kërkuar informata shtesë këtij Këshilli lidhur me ativitetin e z.Tunuzliu pas viteve te 90-ta.Në bazë të informatave që ia ka kthyer Këshilli Prokurial dhe Gjyqësor, Komisionit,shtoi z.Bajrami,është konstatuar se z.Tunuzliu gjatë viteve të 90-ta ka punuar në detyra me përgjegjësi në Shtëpinë Ndëshkuese-Korrektuese në Smrkonicë dhe për shkakë të përgjegjësive që ka pasur,ai kishte stazh të benificuar.

Dukue u nisur nga ky fakt,theksoi z.Bajrami,Komisioni për Çështje gjyqësore,Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese i propozon Kuvendit të Kosovës që mos ta jap pëlqimin e tij, për emrimin e z.Tunuzliu në postin e zëvendës prokurorit të qarkut në Mitrovicë.

**Opinionet dhe vërejtjet e veta lidhur më këtë çështje i dhanë edhe deutetët Hydajet Hyseni,Mehdi Bardhi dhe Dragisha Krstoviq që i janë bashkangjitur transkriptit.**

**Kryesuesi** e vuri në votim rekomandimin e Komisionit për çështje Gjyqësore,Legjislacion dhe Kornizë kudhtetuese dhe rezultati ishte,si vijon:

Për-----56,  
Kundër-----1,  
Abstenime-----20.

Kryesuesi konstatoi:Kuvendi i Kosovës e miratoi rekomandimin e Komisionit për Çështje Gjyqësore,Legjilative dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me emrimin e gjyqëtarve dhe të prokurorve dhe me këtë vendim duhet të informohet PSSP-ja.

#### **7. Parashtrimi i pyetjeve-përgjegjjet me gojë.**

**Deputeti Ismajl Kurteshi** i kishte parashtruar tri pyetje ministrit Jaku Krasniqi:a)sa respektohet ligji për rregullimin e shërbyesëve civil dhe si funksionon pushteti lokal në teritorin e Kosovës?,b)Cilat janë përgjegjësit e ministrisë së Shërbimeve Publike për administratën gjyqësore dhe c)A lejohet mbajtja e dy vendeve të punës dhe realizimi i rrogave nga buxheti i konsoliduar i Kosovës për deputetët e Kuvendit të Kosovës?

**Deputeti Alush Gashi** i kishte parshtruar pyetje të njëjtit ministër, se çka ka bërë ministria e Shërbimeve Publike për pajisjen me dokumente të udhëtimit për qytetarët e Kosovës të cilët përkohsisht gjenden në botën e jashtme?

**Ministri Jakup Krasniqi** iu përgjigj gojarisht pyetjeve të parashtruara nga deputetët Ismajl Kurteshi dhe Alush Gashi.

**8. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare që duhet të mbahet më 29 maj 2003.**

Kryesuesi propozoi për seancën e ardhshme, këtë rend dite:

1. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për rrugët,
2. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për prokurimin publik në Kosovë-2003/13,
3. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për ndryshimindhe plotësimin e Ligjit për themelimin e regjistrit të të drejtave në pronësinë e paluajtshme-2003/14.

Kuvendi e miratoi rendin e ditës për seancën e ardhshme plenare që duhet të mbahet më 29 maj 2003.

Seanca përfundoi në orën 13:00.

Sekretaria e Kuvendit

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,  

---

akademik Nexhat Daci